



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DELVINË**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Delvinë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PROCES VERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje automjeti zjarrfikës për nevojat e sektorit të Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarri (M.Z.SH), Bashkia Delvinë”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Automjete zjarrfikëse 34144210 - 3**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 4.333.333 (katërmilionë e treqindë e tridhjetë e tre mijë e treqindë e tridhjetë e tre) Lekë, pa TVSH, vlerë e cila është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit Kontraktor për vitin 2024, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 47, datë 22.12.2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Delvinë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8;*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP-së, nenit 26, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

- Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, pika 1 e Shtojcës 7.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së, nenit 40, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të certifikuara të bilanceve vjetore, të konfirmuara prej Administratës Tatimore, përkatësisht për tre vitet e fundit financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku bilanci i secilit vit nuk duhet të ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Operatorët ekonomik të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e mësipërme "c" të nenit 41 të ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, oraganizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

**2.2.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (përkatësisht vitet 2021, 2022 dhe 2023), ku vlera e xhiros vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur edhe në qoftë se operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar më lart nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenin 43, pika 2, gërma c (*në rastin e procedurës së hapur të thjeshtuar neni 55, pika 4*) të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

**2.2.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim nga organet e pushtetit vendor për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2023 (Për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetim të lëshuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

**Argumentimi:** Ky kriter kërkohet për pagesat e taksave vendore bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore si dhe faktit ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit/ve të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

➤ **Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit (sipas Shtojcës Nr. 8). "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**Përsa i përket aftësisë teknike, operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti/Enti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:**

**2.3.1 Dëshmi për furnizime të ngjashme të mëparshme** në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përllogaritur të kontratës, për të cilën konkuron operatori ekonomik, që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës si më poshtë:

- a. Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një Ent publik, kontrata furnizimi dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.
- b. Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara dhe të jenë të deklaruar në organet tatimore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

## **2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 ose ekuivalente me të. Certifikata duhet të jetë e vlefshme, të përfshij objektin e prokurimit dhe të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standarteve ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 është e nevojshme si kriter kualifikues pasi lidhet me natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të vërtetuar dhe të garantoj realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

**2.4.2** Operatori ekonomik duhet të paraqes një "**Deklaratë**", nëpërmjet së cilës të deklaroj se merr përsipër lëvrimin e plotë të mallit objekt prokurimi (Transportin e mjetit zjarrfikës) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e lidhjes së kontratës dhe se detyrimisht do të mbuloj me veprimet dhe shpenzimet e tij të gjitha pagesat në lidhje me:

- Tarifën e kontrollit fizik;
- Tarifën e regjistrimit (targat);
- Taksat vjetore;
- Pagesën për kontrollin teknik të mjetit (në rastet kur nuk përjashtohet nga DPSHTRR);
- Pagesat për TPL (në rast se aplikohet);
- Si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme, pronësie, etj)

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4 të nenit të 77 të ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjisllacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për tu siguruar se operatori ekonomik do të përmbushe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Autoriteti Kontraktor në formulimin e këtij kriteri kërkon prej Përfaqësuesit ligjor të subjektit ofertues një “**Deklaratë**” me anë të së cilës deklaron se merr përsipër transportin e mallit objekt prokurimi (në rastin konkret automjetit zjarrfikës) nga vendndodhja e tij e deri në vendin e ekzekutimit të kontratës (Sektori Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarri Bashkisë Delvinë, Delvinë), pa përfshirë kosto shtesë për këtë shërbim.

Pra të gjitha veprimet dhe kostot do të mbulohen prej operatorit të shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi.

**2.4.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë katalogun/et dhe/ose fragmente të katalogut/eve teknike të prodhuesit/ve ose librezat teknike ose leje qarkulimi dhe foto të ndryshme për automjetin që do të ofertoj, ku të tregohen karakteristikat kryesore teknike të automjetit të ofertuar, të cilat duhet të përmbushin kryesisht/plotësisht specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti/enti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

**Argumentim:** Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve teknike të prodhuesit/ve ose librezat teknike ose leje qarkulimi, është vendosur në përputhje me pikën 6/b të Nenit 40 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është një hap i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut/et ose fragmente të katalogut/eve teknike të prodhuesit/ve ose librezat teknike ose leje qarkulimi e

mjetit jep një informacion të qartë në lidhje me automjetin që do të ofrohet. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth mjeteve. Kjo siguron që Autoriteti Kontraktor ka një pamje të qartë për cilësinë e mjetit që do të ofrohet dhe mund të bëjnë një vlerësim sa më të mirë të ofertave. Së dyti, vendosja e këtij kriteri nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e kërkuar (automjet zjarrfikës). Kjo siguron që mjetet e ofruara janë në pajtueshmëri me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**